

ANILA HIMA, LEDINA MERKAJ

GJUHA JOPARLAMENTARE NË KUVENDIN E SHQIPËRISË

Abstrakt

Kuvendi, si instanca ku merren vendimet politike të një vendi, kthehet shpesh në një arenë debatesh të ashpra politike. Fyerjet dhe akuzat personale e të pahijshme e deri në vulgare e zhvlerësojnë konceptin e debatit duke e ulur nivelin e diskutimeve në standarde të papranueshme për një shoqëri të qytetëruar. Duke përdorur analizën e tekstit në një korpus të përbërë prej fjalimesh të mbajtura gjatë seancash plenare, në këtë punim: (a) analizohet gjendja aktuale e gjuhës joparlamentare të përdorur në sallën e Kuvendit të Shqipërisë, (b) shqyrtohet qëndrimi i kryesuesit të seancës në përputhje me Rregulloren e Kuvendit në lidhje me këtë gjuhë, si dhe (c) pasqyrohet, për analogji, situata parlamentare e vendeve të zhvilluara demokratike. Përfundimet që dalin nga kjo analizë nxjerrin në pah nevojën e domosdoshme për disiplinim apo edhe imponim ligjor për ndryshimin e kësaj mënyre të komunikuar. Ky punim sugjeron një ndërhyrje institucionale të menjëhershme nga autoritetet parlamentare përgjegjëse, për ta rishqyrtuar nenin përkatës të Rregullores së Kuvendit, që lidhet me sjelljen dhe gjuhën e përdorur në Kuvend, duke e specifikuar hollësisht termin *gjuhë joparlamentare* si dhe duke i bashkangjitur edhe një shtojcë të hollësishme fjalësh e shprehjesh që duhen ndaluar gjatë debateve parlamentare. Por, a do të mjaftonte vetëm kaq në zgjidhjen përfundimtare të problemit? Kjo është një nismë e vështirë që përfshin përpjekje shumëplanëshe, porë sigurt është që, kështu, do të kemi një përpjekje ligjore dhe konkrete për sanksionimin e përbërësit joetik në ligjërimin politik shqiptar, për të ruajtur nivelin qytetar të debateve parlamentare dhe për të respektuar etikën parlamentare që është kriteri bazë për vendet demokratike.

Fjalët kyç: *ligjërim politik, gjuhë joparlamentare, etika, ndërhyrje institucionale, Kuvendi i Shqipërisë, Rregullore e Kuvendit.*

1. Hyrje

Kuvendii Republikës së Shqipërisë është organi më i lartë ligjvënës në të cilin shqyrtohet dhe miratohet legjislacioni i propozuar. Është institucioni ku zhvillohet dialogu politik konstruktiv dhe i qëndrueshëm ndërmjet të gjitha forcave politike për realizimin e reformave të kërkuara dhe përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në kuadër të procesit të Integritetit Europian të Shqipërisë¹. Në funksion të kredos politike përdoret shpesh gjuha e debatit

¹ Sipas *Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë* për vitin 2013, http://www.parlament.al/web/pub/raport_vjetor_17242_1.pdf. [03.05.2014].

joetik, e cila tërheq vëmendjen e elektoratit, jo me argumente dhe polemika konstruktive, por me sulme personale, agresive, me batuta dhe nofka banale e vulgare, që kanë ndikim të menjëhershëm në median elektronike e të shkruar, të cilat përdoren si rubrika sensacionale të modelit të skandaleve të figurave të njohura televizive. Sipas Artan Fugës, “në shumicën e rasteve, retorika politike për çështje të caktuara degjeneron në debate banale, duke treguar një mungesë të theksuar etike, profesionalizmi dhe për përgjegjësinë e përfaqësimit të qytetarëve². Sipas Van Eemeren-it (1992), shkëmbimet fjalësore të deputetëve janë shumë larg diskutimit kritik ideal të përshkruar në teoritë e ndryshme normative të argumentimit. Polemikat shpesh përfshijnë vrazhdësi, mungesë respekti, armiqësi, fyerje, sulme verbale, keqinterpretime, devijime në tema të panevojshme e irrelevante, mostolerancë, dogmatizëm, energji të harxhuar kot, dështime të komunikimit dhe harxhim kohe e talenti (Govier 1999). Për sa i përket shkallës së agresivitetit të ligjërimit politik në Shqipëri në vitet e fundit, prof. Xhevat Lloshi shprehet se “është e pakrahasueshme edhe me vendet e tjera, që kaluan nëpër të njëjtin tranzicion” (Lloshi 2012: 239).

Ligjërimi politik i figurave kryesore politike shqiptare është analizuar në një studim të fondacionit *Shoqëria e Hapur për Shqipërinë* (OSFA), realizuar nga një grup ekspertësh nga shkencat politike, filozofia, gazetaria e gjuhësia. Ata kanë dalë në përfundimin se 45% e ligjërimit të secilit prej këtyre aktorëve politikë që i kushtohet tjetrit “janë fyerje të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta personale karakteri, akuza pa bazë dhe krahasim apo asocim i kundërshtarit me tipare politike të së kaluarës ose figura politike botërore me imazh negativ” (Studimi i OSFA-s 2012: 2-3).

Sfera politike, e në veçanti Kuvendi, është një hapësirë përplasjesh mendimesh, politikash, interesash, ku mund të konfliktohesh lehtë, por deputetët duhet të ruajnë etikën parlamentare dhe t’i bëjnë të qarta dallimet e tyre politike brenda kufijve të një gjuhe të qytetëruar. Liria e fjalës është e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kreu II mbi Liritë dhe të drejtat vetjake, neni 22. Megjithatë, nuk i jep të drejtë të pakufizuar deputetit të thotë ç’është do të përdorë gjuhë ofenduese ose joparlamentare. Ajo që pritet prej tyre është që ata të veprojnë në përputhje me normat e caktuara në Rregulloren në lidhje me gjuhën e përdorur, për të ruajtur nivelin e lartë të debateve parlamentare dhe dinjitetin e Kuvendit si organi më i lartë ligjvënës.

2. Gjuha joparlamentare në kuvendet e vendeve të zhvilluara

2.1. Rregullat formale të debatit

Në Dhomën e Ulët të Parlamentit Britanik (British House of Commons), rregullat formale të debatit janë të përcaktuara në traktatin e Erskine May-it, (*Treatise on the Law, Privileges, Proceedings and Usage of Parliament*),

² Cituar nga Suela Musta në *Studime Albanologjike*, 2011: 147.

botuar për herë të parë në 1844 dhe ribotuar shumë herë deri në ditët e sotme. Ai përfaqëson një kod të sjelljes i cili shërben si rregullator për format e ndryshme të bashkëveprimit parlamentar dhe garanton ecurinë e duhur të debatit politik, me qëllim shmangien e përplasjes politike përmes argumenteve të ashpra brenda sallës, gjë e cila, mund të çonte në mosfunksionim të debatit. “Anëtarët e parlamentit duhet të zbatojnë disa rregulla formale të debatit, të cilat sigurojnë që shkëmbimet fjalësore të mos bëhen tepër personale dhe ballafaqese. Për këtë arsye, të gjitha fjalimet duhet të nisin me ‘zonja/zoti drejtues i seancës’ (Madam/Mister Speaker) dhe t’i drejtohen kundërshtarit politik në vetën e tretë e jo drejtpërdrejt me *ju*” (Shaw 2011: 303). Arsyeja që anëtarët duhet t’u drejtohen njëri-tjetrit në mënyrë indirekte dhe jo drejtpërdrejt në emër shpjegohet nga Jeremy Bentham: “nëse anëtarët i flasin drejtpërdrejt njëri-tjetrit, diskutimi mund të kalojë më lehtë në nivel personal” (Bentham 1999: 134). Mënyra indirekte e adresimit në Parlamentin britanik nuk është një praktikë që përdoret kudo. Në të tjera parlamente, si për shembull në atë francez apo italian, anëtarët e Parlamentit u drejtohen anëtarëve të tjerë me ‘ju’, si një formë nderimi për të treguar respekt apo distancë.

2.2. Botimet e posaçme në lidhje me gjuhën joparlamentare

Në rastet kur në parlament një deputet përdor fjalë e komente të papranueshme, kryetari i Kuvendit, së pari, i kërkon atij t’i tërheqë ato. Rastet kur refuzohet të tërhiqet një koment joetik mund të çojnë në masa disiplinore ndaj tij. Për të përmbushur këtë detyrë, kryetari i Kuvendit i referohet një botimi të posaçëm të parlamentit që përmban fjalët e shprehjet e papranueshme në Kuvend. Në Kanada, për shembull, sipas zyrës së Kryetarit të Kuvendit, Rregullorja e Dhomës së Ulët të Kanadasë (Beauchesne’s Rules & Forms of the House of Commons of Canada) edicioni i 6-të (1989) përmban përmbledhjen më të fundit të fyerjeve, insinuatave, epiteteve dhe akuzave që janë shprehur në Kuvend ndër vite dhe që janë etiketuar si “gjuhë joparlamentare”³; në Maltë, rregullorja e Parlamentit vlerësohet si “Bibla” e Parlamentit⁴; apo, në Indi është botimi i sekretariatit të Parlamentit indian (Lok Sabha), i cili përmban fjalët dhe shprehjet e palejueshme që konsiderohen të pahijshme dhe fyese në shumicën e kulturave.

2.3. Raste konkrete të gjuhës joparlamentare dhe të zbatimit të rregullores

Sipas faqes zyrtare të Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, “...një nga detyrat e Kryetarit të Parlamentit është të sigurojë që deputetët të mos përdorin gjuhë fyese ose të pahijshme dhe të mos e akuzojnë njëri-tjetrin për gënjeshtër,

³ <http://www.ipolitics.ca/2011/12/14/the-106-things-you-cant-say-in-parliament/> [05.04.2014].

⁴ <http://www.independent.com.mt/articles/2014-05-18/books/speakers-rulings-in-the-parliament-of-malta-5052465153/> [05.04.2014].

dehje apo shtrembërim fjalësh. Disa fjalë ndaj të cilave është tërhequr vërejtje nga Kryetari i Kuvendit ndër vite janë: *maskara, frikacak, fëmijë rrugësh, huligan, mi, derr* dhe *tradhtar*. Deputetët ndonjëherë u shpëtojnë me zgjuarsiri këtyre rregullave, siç është, rasti i famshëm i Winston Churchill-it, i cili përdori frazën *pasaktësi terminologjike* për të thënë *gënjeshtër*, apo të jesh *ekonomik me të vërtetën* për të aluduar *mashttrimin*⁵.

Në Zelandë të Re janë të ndaluara deklaratat drejtuar deputetëve të tjerë, të tilla si: *Ata kanë energjinë e një kërmilli të lodhur që kthehet në shtëpi pas një funerali*, apo *Truri i tyre mund të vijë vërdallë brenda lëvozhgës së kikirikës për një mijë vjet pa prekur anët*.⁶ Deputetët e Afrikës së Jugut tregojnë një prirje të veçantë për përdorimin e kafshëve në fyerjet e tyre. Disa nga fyerjet që vlerësohen si joparlamentare janë: *mace e dhjamur, mja* (mjauullima e maces), *këlysh i uritur, çiuaua* (ang. *chihuahua*) apo *gomar*.⁷ Emra të tillë si *Hitleri, Musolini* janë po ashtu të papranueshëm dhe janë dëbuar nga leksiku parlamentar. Në Dhomën e Ulët të Parlamentit Irlandez (Dáil Éireann) është e palejueshme që një anëtar i Kuvendit të përshkruajë një tjetër me fjalë të tilla, si: *kloun, komunist, frikacak, fashist, fëmijë rrugësh, hipokrit, mi*; ose të nënkuptojë se një anëtar i Kuvendit është i dehur.⁸ Në Australi, fjalët *gënjeshtar* dhe *dumbo*⁹ konsiderohen si joparlamentare që prej një debati politik në 1997.¹⁰ Në Asamblenë e Wellsit, në dhjetor 2004, një deputete u përjashtua nga salla e Parlamentit, sepse i ishte drejtuar Mbretëreshës Elizabeta II, me *Znj. Windsor*.¹¹ Në Parlamentin indian, gjatë një debati më 9 dhjetor 2005, një anëtarit të Parlamentit iu tërhoq vërejtje, pasi e përshkroi qeverinë si një *kopsht plot me barëra të këqija*, për të nënkuptuar se qeveria përbëhej nga njerëz të paaftë¹². Termi *fashist* ka qenë pjesë e fjalorit politik që prej Luftës së Dytë Botërore, por një anëtar i Parlamentit indian u fajësua për përdorimin e këtij termi, kur, me të, cilësoi një parti politike¹³. Në kontekste të caktuara, askush nuk mund të përdorë fjalë të tilla si: *derë e*

⁵ <http://www.parliament.uk/site-information/glossary/unparliamentary-language/> [05.04.2014].

⁶ <http://www.pa.org.za/blog/unparliamentary-behaviour-things-mps-have-said> [05.04.2014].

⁷ Po aty.

⁸ <http://www.bbc.co.uk/news/uk-northern-ireland-16392578> Salient Rulings of the Chair (2nd ed.) Dublin: Dáil Éireann. May 2002. §408. [04.2014].

⁹ *dumbo*: elefant me veshë të mëdhenj, marrë nga një personazh përralle për fëmijë.

¹⁰ "Senate Official Hansard: Thirty-eight parliament first session—fourth period". Parliament of Australia. 16 June 1997. p. 38. [05.04.2014].

¹¹ http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk_news/wales/4060043.stm "AM expelled for 'Mrs Windsor' jibe". BBC News. 1 December 2004. [05.04.2014].

¹² http://articles.economictimes.indiatimes.com/2009-01-02/news/27646564_1_weed-unparliamentary-rajya-sabha [05.04.2014].

¹³ Po aty.

fshehtë, tradhtoj, gjysma më e mirë, konspiracion, e rremë, mashtrim, e palogjikshme, të vjetëruara, gënjeshtar, tallje, paratë e huaja, shaka, i turpshëm dhe qesh nën hundë. Kryeministri britanik David Cameron-i u akuzua për shkelje të gjuhës parlamentare, pasi e kishte quajtur *hipokrit* një deputet tjetër, gjë për të cilën u detyrua të kërkojë ndjesë¹⁴. Pas një debati të ashpër mes kundërshtarësh politik në Parlamentin e Kebekut në 2007, fjala *treguesi sinoptik i erës* (ang. weathervane) u shtua në listën e fjalëve joparlamentare, pasi u përdor për një lider partie, i cili shkonte nga frynte era¹⁵. Ndërsa, në mars 2008, një deputet i Parlamentit kanadez kërkoj ndjesë, pasi ishte shprehur, në një kontekst të caktuar, se një ish-kryeministër duhej varur¹⁶. Në Parlamentin grek, në maj 2013, u përjashtuan nga Parlamenti deputetët që thirrën *Rroftë Hitleri!*¹⁷. Në dhjetor 2009, një deputet irlandez kërkoj ndjesë për shkelje të gjuhës parlamentare, pasi ofendoj një kundërshtar politik me shprehjen *F... you!*. Çuditërisht, kjo frazë nuk ishte në listën e fjalëve të papërshtatshme për Parlamentin, por bëri që komisioni përgjegjës ta rishqyrtojë rregulloren për ndryshimet e nevojshme¹⁸.

Vendosja e kësaj tematike në kontekst nuk duhet marrë si një mënyrë për të justifikuar ligjërimin negativ të politikanëve shqiptarë, por për të kuptuar se si gjuha e pahijshme dhe pa vend në parlamentet e huaja mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme gjatë seancave plenare, si dhe sanksionohet, sipas kontekstit, nga drejtuesi i seancës. Këto ndërhyrje nuk kanë mundur të shmangin dot shumë raste ekstreme të përplasjeve politike si fjalësore ashtu edhe fizike, por kanë treguar se Kuvendi, si instanca më e lartë ligjvënese e një vendi drejtohet nga rregulla të mirëpërcaktuara që garantojnë mbarëvajtjen e qytetëruar të debatit politik, rregulla të cilat rishqyrtohen dhe përditësohen rregullisht për të qenë aktuale me kohën.

3. Studimi

Qëllimi i këtij punimi është të analizohet në mënyrë objektive dhe neutrale ligjërimi politik, duke u përqendruar, në veçanti, në fjalorin e pahijshëm të përdorur në Kuvend. Nuk synohet të shpjegohen arsyet për këtë fjalor, pasi analiza e tyre do të çonte përtej qëllimit të këtij studimi, por që do të kishte mjaft vlerë si një studim i thelluar në të ardhmen. Cilatdo qofshin arsyet për këtë fjalor, ato nuk mund të justifikojnë një gjuhë politike të

¹⁴ <http://www.theguardian.com/politics/2012/feb/01/prime-minister-questions>. [05.04.2014].

¹⁵ "The Role of the Speaker of the House of Commons". Parliament of Canada. 25 tetor 2001. [05.04.2014].

¹⁶ <http://www.theglobeandmail.com/news/politics/politicians-behaving-badly-seven-mps-who-used-unparliamentary-language/article6075582/> [05.04.2014].

¹⁷ <http://www.shqiptarja.com/bota/2728/greqi-perjashtohen-nga-parlamenti-deputetet-thone-rrofte-hitleri-157214.html>, 17 maj 2013. [05.04.2014].

¹⁸ <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/8413122.stm>. "Changes expected to Dáil code after use of 'f-word'". The Irish Times, 15 dhjetor 2009. [05.04.2014].

pahijshme me akuza personale. Në analizë do të merren në shqyrtim të gjitha seancat plenare të mbajtura në sesionin e parë dhe të dytë (deri më 30 mars 2014) të Legjislaturës së VIII të Republikës së Shqipërisë. Në mënyrë të veçantë, do të analizohen dy seanca plenare: (1) seanca për miratimin e buxhetit 2014, dhe (2) debati për marrëveshjen me FMN-në si dhe për kompensimin e ish-pronarëve dhe ish-të përndjekurve, e datës 20 mars 2014. Janë përzgjedhur, në mënyrë të veçantë, këto dy seanca për arsye se diskutimet mes kundërshtarëve politikë kanë qenë të ashpra, me një nivel të lartë të retorikës dhe me shpalosje të një fjalori të rëndë në rrafshin etik duke krijuar situata të tensionuara.

Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë është miratuar në vitin 2004, me disa rishqyrtime në 2005, 2008, 2010, 2011 dhe 2013. Në këtë rregullore, në lidhje me sjelljen në Kuvend, në kreun IX, neni 62, jepet shprehimisht që “anëtarët e Kuvendit duhet të mos përdorin gjuhë ofenduese dhe joparlamentare në Kuvend”, por nuk ka asnjë përcaktim të hollësishëm se çfarë nënkuptohet me gjuhë ofenduese dhe joparlamentare, apo asnjë listë të specifikuar fjalësh a shprehjesh të ndaluara. Kjo është një pjesë e rregullores e cila, siç u ilustrua edhe më lart, përditësohet vazhdimisht në botimet parlamentare të vendeve të zhvilluara. Ndërsa në Kuvendin e Shqipërisë, ky vlerësim a përcaktim i gjuhës joparlamentare i lihet në dorë kryetarit të Kuvendit. Edhe në Belgjikë, mungon një përkthim i hollësishëm i gjuhës joparlamentare në rregulloren e Kuvendit, por në një rast, kur kryeministri u quajt *pedofil* nga një anëtar i Parlamentit në mars 2014, deputetët e tjerë u ngritën dhe dolën nga salla e parlamentit në shenjë proteste ndaj kësaj gjuhe¹⁹. Reagime të tilla nuk kemi në historinë e Kuvendit shqiptar.

Duke përdorur analizën e tekstit në korpusin tonë do të analizohet gjendja aktuale e gjuhës joparlamentare e përdorur në sallën e Kuvendit të Shqipërisë. Më tej, do të shqyrtohet qëndrimi i kryesuesit të seancës në përputhje me Rregulloren e Kuvendit në lidhje me këtë gjuhë, si dhe do të pasqyrohet edhe qëndrimi i vetë anëtarëve të Kuvendit në lidhje me gjuhën joparlamentare.

3.1. Gjendja e gjuhës joparlamentare në Kuvendin e Shqipërisë

Nga analiza e korpusit rezulton se, për sa i takon gjuhës joparlamentare të përdorur gjatë punimeve në Kuvend, ajo manifestohet me trajta nga më ‘të larmishmet’ e të tejskajshmet, me fjalë e shprehje tabu, vulgare, fyese e kërcënuese drejt kundërshtarëve politik. Megjithatë, në këtë punim, për të respektuar etikën e shkrimit, është bërë një përzgjedhje shembujsh.

Duke ndjekur modelin e studimit të OSFA-s, fjalori i përzgjedhur për këtë analizë ndahet në tri kategori: karakteri, performanca dhe përkatësia²⁰.

¹⁹ <http://voiceofrussia.com/politics/2014/03/28/> [15.04.2014].

²⁰ Për përkthimin e tri kategorive është ndjekur modeli i studimit në *Analiza e ligjërimit politik* nga fondacioni i OSFA-s, dhjetor 2012 [05.04.2014].

1. “Kategoria e karakterit përfshin cilësime personale që i referohen paraqitjes, inteligjencës, aftësive, qëndrimit dhe sjelljes së kundërshtarit. Ato mund të jenë tipare, cilësi moralo-etike dhe veçori që përbëjnë personalitetin e një individi” (Studimi i OSFA-s 2012: 10). Tipare të tilla shprehen me fjalë, shprehje apo edhe fjali në formën denotative por edhe figurative, si për shembull: *hajdut ordiner, synetllëk, zhuls, paranojak, fytyrëpalarë, kokëpalarë, simbol i hajdutit, ordiner rruge, mashtrues ordiner, pervers, hanëm me kollare, efendëm çakall, akt skizoik, i pafytyrë, skizofren, shpifës ordiner, qelbej erë, kokainë, futi dozën, futi viza, ti nuk je burrë, mendje e sëmurë me zero njohuri ekonomike, ju mori të gjithëve për hunde, lakuriq mbi gomar, nuk ke pikën e burrnisë, ti ferrin e ke brenda, duke bërë rrugaçëria nga tavolina, ti shpërfytyron veten, njëra pas tjetrës të kanë ndarë pesë gra.*

Tek kjo kategori zënë një vend të gjerë edhe kërcënimet, poshtërimet si dhe batutat e humori banal që kanë për shënjestër personalitetin e kundërshtarit.

(1) [...] ti je një hiç, një mashtrues ordiner, një njeri pa diplomë, një njeri që ka bredhur rrugëve.

(2) Këto që the, do t’i lajë familja jote. Mbylle gojën! Mos fol!

(3) Uleni kokën ju! Bërtisni sa të doni! Këto janë të vërteta.

(4) Mbylle gojën, se mund të them gjëra që nuk kam ndërmend t’i them tani, se po flas për buxhetin, se po të hyj e të flas për ty, e di vetë si të pikturoj unë ty, të bëj autoportretin më origjinal që të ka bërë kush ndonjëherë. Ta bëj autoportretin në të gjitha variantet, e kupton ti vetë [...] siç e di ti, shqeto e shqeto. Po rri aty e dëgjo ose dil jashtë po deshe.

(5) Ata që të bënë synet politik, ata të hoqën edhe forcën e fundit të burrit ty.

(6) I di mirë ti, mor mashtrues! Gruaja jote doli e u tha shqiptarëve...

(7) E mban mend atë plakun që nxirrte tym nga mbrapa...

(8) Sepse edhe një fëmijë ka më shumë dinjitet se ti. Edhe çdo rojë këtu ka më shumë dinjitet se ti. Dhe çdo kopshtar ka më shumë dinjitet se ti. Dhe çdo njeri që punon te bari dhe çdo sanitare ka më shumë dinjitet se ti.

Fragmenti i fundit është një poshtërim tejet agresiv i personalitetit të kundërshtarit, në një pikë të tillë ku në të përfshihen dhe poshtërohen edhe individë të tjerë të shoqërisë jashtë sallës së Kuvendit, të cilët punojnë me respekt e dinjitet në profesionin e tyre.

2. “Kategoria e performancës i referohet veprimtarisë publike të kundërshtarit bërë në formë vlerësimi dhe gjykimi” (Studimi i OSFA-s 2012: 10). Cilësime si për veprimtarinë publike personale të individit, ashtu edhe të zyrës që ai përfaqëson, përfshijnë ndër shumë të tjera: *akte makabre, synet politik, para të vjedhura, prag diktature, heshtja e varrit e shumë deputetëve, kastrim i plotë politik i kabinetit, krim, fabrikë mashtrimesh, megamashtrim, korrupsion, kontrabandë, i drejtohem qeverisë që bën orgjira, pazaret e 1*

prillit, larja e parave, fshehja e pasurisë, bilanc i frikshëm mashtrimi në çdo fushë dhe në çdo sektor.

(8) Je simbol i paaftësisë qeverisëse mbi tokë, i pafajshëm për një aspekt, se ti je një analfabet që nuk merr vesh asgjë.

(9) Nuk flet vetë këtu, por shërbehet me njerëz të dënuar nga gjykatat për shpifje, me trafikantë droge dhe prostitucioni, të skeduar për trafikë. Po të jesh burrë, duhet të dalësh këtu dhe të flasësh.

3. Kategoria e përkatësisë “përfshin ato cilësime që një ligjërues bën për tjetrin duke e asociuar atë me një grup stereotipik me rezonanca kulturore negative” (Studimi i OSFA-s 2012: 10), si në rastet: *banditizëm gjyqësor, shokët e krimit, trafikantë droge dhe prostitucioni, kollovar Serbie, mbeturinat më të shëmtuara të regjimit komunist, mafia, bllokmen, Gërdeci, skuadër sharësish profesionistë të implikuar në dhjetëra afera.*

3.2. Ndërhyrjet e drejtuesit të seancës plenare në Kuvendin e Shqipërisë

Sipas rregullores së Kuvendit, nenit 64, pika 1, “kur deputeti thotë fjalë të pahijshme, pengon me sjelljen e tij zhvillimin e seancës plenare ose cenon rregullin e saj, i tërhiqet vëmendje nga drejtuesi i seancës plenare”. Ndërsa, sipas nenit 63, masat disiplinore që zbatohen ndaj deputetëve, kalojnë nga (1) tërheqje vëmendjeje në (2) vërejtje, në (3) përjashtim nga seanca plenare e deri në (4) përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare deri në 10 ditë, i cili shoqërohet edhe me sanksione financiare.

Në korpusin tonë nuk ka asnjë vërejtje apo ndëshkim nga kryesuesi i seancës në lidhje me gjuhën joparlamentare. Disa nga ndërhyrjet dhe thirrjet e drejtuesit të seancës për të garantuar ecurinë e përpiktë të debatit, për të ‘ruajtur rendin’ brenda sallës së Kuvendit dhe për normalizimin e debatit parlamentar janë:

(10) Secili tregon edukatën e tij!

(11) Ju lutem [...] kini parasysh që na dëgjojnë njerëzit!

(12) [...] i ftoj të gjithë kolegët që ndodhen këtu të jenë më të përgjegjshëm, të ruajnë etikën parlamentare, të shprehin mendimet e tyre, t’i bëjnë të qarta dallimet e tyre politike, por e kemi për detyrë ta respektojmë njëri-tjetrin [...]

Moszbatimi i rregullores në këtë pikë dhe toleranca e drejtuesit të seancës pranohen edhe nga vetë drejtuesi i seancës, i cili shprehet:

(13) Ju lutem! Po të ishte për Rregulloren, këtu duhet të ishte përjashtuar një e treta e diskutantëve për gjuhën e përdorur.

3.3. Reagimet e deputetëve brenda sallës

Pjesa e mëposhtme e shkëputur nga një fjalim i mbajtur në Kuvend tregon rëndësinë e etikës, si hapi i parë i komunikimit institucional, si triumfi i së vërtetës mbi opinionin personal, i logjikës mbi instinktet:

(14) Në politikë [etika] ka po aq rëndësi sa çështjet që trajtohen. Mjerisht, po ndodh që etika parlamentare nuk po respektohet as minimalisht nga

shumica e deputetëve [...] Ne jemi dëshmitarë që në çdo seancë akuzat, sharjet dhe fyerjet zënë pjesën më të madhe të kohës dhe kjo ka zhvlerësuar jo pak peshën tonë si të zgjedhurit e popullit në Kuvendin e Shqipërisë. Me këtë rast bëj thirrje që të respektojmë maksimalisht etikën.

Indinjata e disa deputetëve për fjalorin e ulët, mospërmbajtjen dhe mosrespektimin e etikës në sallën e Kuvendit, si dhe thirrjet për ndërhyrje dhe zbatim të rregullores nga drejtuesi i seancës shprehen në disa pjesë të shkëputura, si më poshtë:

(15) ...Por njëkohësisht marr shkas për t'ju kërkuar që të ndaloni në mënyrë të rreptë përdorimin e një gjuhe si ajo që u përdor javën e kaluar në seancën e Kuvendit.

(16) Procesverbalit të sotëm [...] i mungon paragrafi që do të zbardhte fjalorin skandaloz në seancën e shkuar [...] dhe etika e gjithë qytetarëve që na ndjekin nga ekrani nuk e pranon atë fjalor.

(17) Sipas Rregullores së Kuvendit, me këto fjalë përjashtohesh nga seanca plenare dhe kështu duhet të ishte normalisht, të ndalonim seancën. Biem dakord të gjithë, që nuk ka përjashtim për askënd [...] Ju kërkoj që çdo deputet në këtë seancë t'i bindet Rregullores së Kuvendit. Kjo që ndodhi pak më parë këtu, është e turpshme. Unë mendoj se nuk mund të ketë një kuvend ku përdoret një fjalor i tillë.

(18) Jam absolutisht në favor të respektimit të plotë të etikës dhe kodit etik.

(19) Jam dakord me ato që tha [...] për të ruajtur etikën. Jemi deputetë, jemi njerëz të përgjegjshëm, por [...]

Reagimet, indinjatat, thirrjet dhe kritikrat e politikanëve ndaj shkeljes së etikës parlamentare dhe fjalorit të papranueshëm janë të shumta, porse, të drejtuara gjithnjë, pa asnjë përjashtim, drejt kahut të kundërt politik. Për asnjë moment nuk lihet mënjanë të qenurit kundërshtarë të betuar politik për të vlerësuar drejt e në mënyrë të paanshme gjendjen e papranueshme të krijuar në Kuvend. Pra, reagimet kundërshtuese nuk janë të karakterit etik, por për kredo politike, çka e bën të pavlefshëm ndikimin që ato mund të kishin në parandalimin e fenomenit të vulgaritetit, apo në nxitjen për ligjërime politike korrekte brenda kodit moral e civil.

4. Përfundime

Përfundimet që dalin nga ky punim tregojnë se gjendja aktuale e ligjërimit politik në Kuvendin e Shqipërisë është mjaft e rënduar me fjalë e shprehje tabu nga më 'të larmishmet' e të tejskajshmet, me fjalor vulgar, fyes e kërcënues drejt kundërshtarëve politik. Jemi të gjithë të vetëdijshëm se këto nuk janë raste sporadike, por janë kthyer tashmë në femonen, i cili nuk dënohet apo sanksionohet nga kryetari i Kuvendit. Moskërkimi ndjesë, mosmarrja e masave disiplinore për thyerjen e etikës e bën këtë fenomen fytyrën e shpeshtë të debatit politik dhe i jep gati legjitimitet këtij lloj

komunikimi. Kjo ka bërë që motoja e ligjërimit politik në Kuvendin e Shqipërisë të jetë: “*Qielli është kufiri*”.

Prania apo më mirë “pushtimi” i sallës së Kuvendit nga kjo gjuhë joetike, jocivile, nxjerr në pah nevojën e domosdoshme për disiplinim apo edhe imponim ligjor për ndryshimin e kësaj mënyre të komunikuarit. Ajo që ky punim sugjeron është që, duke ndjekur shembullin e vendeve të zhvilluara, të ndërmerret një ndërhyrje e menjëhershme institucionale nga autoritetet parlamentare përgjegjëse për ta rishqyrtuar nenin përkatës të Rregullores së Kuvendit, që lidhet me sjelljen dhe gjuhën e përdorur në Kuvend, duke e specifikuar hollësisht termin *gjuhë joparlamentare* si dhe duke i bashkangjitur edhe një shtojcë të hollësishme fjalësh e shprehjesh që duhen ndaluar gjatë debateve parlamentare. Por, a do të ishte kjo zgjidhja përfundimtare e problemit?

E sigurt është që, kështu, do të kemi një përpjekje ligjore dhe konkrete për t’i thënë STOP! gjuhës joparlamentare në Kuvendin e Shqipërisë, për të ruajtur nivelin qytetar të debateve parlamentare dhe për të respektuar etikën parlamentare që është tregues i zhvillimit demokratik drejt procesit të Integritimit Evropian të Shqipërisë.

REFERENCA

1. Korpusi i përdorur për analizë:

Procesverbale të seancave plenare të sesionit të parë e të dytë të legjislaturës së VIII të Kuvendit të Shqipërisë, në periudhën shtator 2013 – mars 2014. http://www.parlament.al/web/Sesioni_i_pare_15722_1.php http://www.parlament.al/web/Sesioni_i_dyte_16342_1.php [15.04.2014].

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, marrë nga faqja zyrtare e Kuvendit të Shqipërisë, http://www.parlament.al/web/Rregullorja_e_Kuvendit_te_Republikes_se_Shqiperise_e_perditesuar_1154_1.php.

2. Referencat e shfrytëzuara:

Artan Fuga (2008), *Brirët e Dhisë*. Ora Botime, Tiranë.

Emil Lafi et al. (2012), *Analiza e ligjërimit politik*. Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë. <http://soros.al/2010/article.php?id=420> [04.04.2014].

Frans H. van Eemeren & Rob Grootendorst (1992), *Argumentation, Communication and Fallacies: A Pragma-dialectical Perspective*. Hillsdale: Lawrence Erlbaum.

Jeremy Bentham (1999) [1791], *The collected works of Jeremy Bentham: Political tactics*. (James, Michael, Cyprian Blamire & Catherine Pease-Watkin (eds.)). London: Clarendon.

Suela Musta (2011), Retorika në parlament. Një analizë mbi gjuhën e diskutimeve të deputetëve në seancat plenare (2005-2010). *Studime albanologjike. Komunikimi i integruar. Koncepte, strategji, praktika*. 2011/4, 146-151.

Sylvia Shaw (2011), Governed by the Rules? The Female Voice in Parliamentary Debates. In *Language and Gender: A Reader*, 2nd edition, ed. by J. Coates and P. Pichler, Wiley-Blackwell, 2011, 300-315.

Trudy Govier (1999), *The Philosophy of Argument*. Newport News, VA: Vale Press.

Xhevat Lloshi (2012), *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*. Albas. Tiranë.